REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**GJYKATA KUSHTETUESE**
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**Nr. 40/2021 (JR)** **Tiranë, më 24.02.2022**
**Nr. 40/5 regj.**

# SHPALLJE
# E
# NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË GJYQËSORE PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se ditën **e enjte, në datën 31.03.2022, ora 10:00**, do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri 40/2021, datë 23.07.2021, për ankimin e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 393, datë 03.06.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Gerd Hoxha.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

| | |
|---|---|
| **Kryesuese e Trupit Gjykues** | **Rezarta Schuetz** |
| **Relatore e Çështjes** | **Albana Shtylla** |
| **Anëtare** | **Ina Rama** |
| **Anëtare** | **Natasha Mulaj** |
| **Anëtar** | **Sokol Çomo** |

Bazuar në nenin 460 pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**

**GJYQTAR**

**REZARTA SCHUETZ**